

Në mbështetje të nenit 61 paragrafi 6 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 7/2005, 47/2006 dhe 42/2007), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

## **RREGULLOREN PËR MËNYRËN E TRANSPORTIT TË ARMËVE DHE MUNICIONEVE PËRMES KUFIJVE SHETËTORË**

### Neni 1

Kjo Rregullore rregullon mënyrën e transportit të armëve dhe municioneve përmes kufijve shtetërorë.

### Neni 2

Transporti i armëve dhe municioneve kryhet në pikat e kalimit kufitar të caktuara për kalimin e kufirit shtetëror, ku kryhet kontrolli i rregullt kufitar (në vijim referuar si pika e kalimit kufitar).

### Neni 3

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë ose shtetasit e huaj që mbajnë me vete ose në automjetin e tyre armë dhe municione dhe kanë për qëllim të kalojnë kufirin shtetëror, duhet të deklarojnë armët dhe municionet që kanë për qëllim të transportojnë duke e informuar qartë oficerin e policisë në pikën e kalimit kufitar (në vijim referuar si: oficeri i policisë) se kanë për qëllim të transportojnë armë dhe municione përmes kufirit shtetëror.

### Neni 4

Pasi deklarojnë armët dhe municionet, individët e përmendur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, i paraqesin për kontroll oficerit të policisë një kopje origjinale të dokumentit për këto armë dhe municione.

Kopja origjinale e dokumentit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përveçse i referohet armëve dhe municioneve të përmendura në paragrafin 1 të kësaj Rregulloreje, vërtetohet edhe nga ana e oficerit të policisë me vulë, nënshkrim, numër dhe datën në të cilën është kontrolluar dokumenti.

Pas verifikimit të kopjes origjinale të dokumentit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, oficeri i policisë me shkrim dore shënon në dokument sasinë e armëve dhe të municioneve të cilat po transportohen përmes kufirit shtetëror, pas së cilës dokumenti i kthehet individit.

Një fotokopje e dokumentit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ruhet në arkivën e pikës së kalimit kufitar, ndërsa të dhënat e dokumentit për individin dhe për armët dhe municionet, regjistrohen në regjistrin përkatës të armëve dhe municioneve.

### Neni 5

Pas kryerjes së veprimeve të përmendura në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, nga ana e oficerit të policisë kryhet inspektimi i armëve dhe municioneve me të cilat individit që ka për qëllim të kalojë në pikën e kalimit kufitar qoftë me vete ose në automjetin e tij/saj.

### Neni 6

Oficeri i policisë i cili gjatë kontrollit të individit ose të automjetit të transportit, gjen armë dhe municione të padeklaruara, thënë ndryshe për të cilat nuk është paraqitur për kontroll kopja origjinale e dokumenteve, përveç vendimit për sekuestrim të përkohshëm të armëve dhe municioneve, lëshon dhe një mandat për sendet e konfiskuara përkohësisht.

Mandati i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat e mëposhtme: emrin

dhe mbiemrin e individit të cilit i janë sekuestruar përkohësisht armët dhe municionet, datën e lindjes, vendbanimin, d.m.th. vendin e njohur të qëndrimit të përhershëm, armën (kategoria, lloji, marka, kalibri dhe numri i serisë), municionet (sasia dhe kalibri), bazat mbi të cilat është bërë sekuestrimi, karakteristika të tjera të armës, sidomos dëme të caktuara të dukshme dhe emrin dhe mbiemrin e oficerit të policisë që ka bërë sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

#### Neni 7

Gjatë deklarimit të armëve të gjuetisë dhe të municioneve që përdoren për gjueti ose armëve dhe municioneve sportive të cilat përdoren gjatë stërvitjeve dhe pjesëmarrjes në gara të qitjes, shtetasit e huaj ose anëtarët e organizatave të huaja të qitjes, i paraqesin oficerit të policisë një kopje origjinale të dokumentit të armëve dhe municioneve, si dhe ftesën për gjueti ose ftesën për të marrë pjesë në garat e qitjes ose në stërvitje.

Në bazë të dokumentit të paraqitur të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nga ana e oficerit të policisë lëshohet një leje për mbajtjen e armëve të gjuetisë ose të armëve sportive për gjueti, ose për të marrë pjesë në stërvitjet ose garat e qitjes në Republikën e Maqedonisë.

Në përfundim të gjuetisë ose të stërvitjes dhe pjesëmarrjes në garat e qitjes, individët e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i dorëzojnë oficerit të policisë lejen e lëshuar të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni përpara largimit nga Republika e Maqedonisë.

#### Neni 8

Shtetasit e huaj që kanë blerë armë dhe municione në Republikën e Maqedonisë i deklarojnë këto armë të cilat kanë për synim t’i nxjerrin jashtë Republikës së Maqedonisë përpara oficerit të policisë në pikën e kalimit kufitar në të cilën kalojnë kufirin shtetëror.

Përveç deklarimit të armëve dhe municioneve, shtetasi i huaj dorëzon për kontroll kopjet origjinale të lejes për të blerë dhe eksportuar armë dhe municione jashtë Republikës së Maqedonisë, e lëshuar nga organi kompetent, dhe lejen ose çdo dokument tjetër të vlefshëm për blerje armësh të lëshuar nga organi kompetent i një shteti tjetër.

Të dhënat që përmban leja ose dokumenti tjetër përkatës i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, si dhe të dhënat për individin, armën dhe pikën e kalimit kufitar, regjistrohen në regjistrin përkatës të armëve dhe municioneve.

#### Neni 9

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Nr. 13.1-26746/1  
18 prill 2007  
Shkup

Ministre  
e Punëve të Brendshme,  
**MA Gordana Jankuloska**, nënshkrimi